



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 22.15.1 -2012-08

RAPORT I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE TË KOMUNËS SË SUHAREKËS
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2012

Prishtinë, Qershor 2013

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) kryen auditime të rregullsisë si dhe ato të performancës. Auditori i Përgjithshëm, Lage Olofsson, është kreu i ZAP-it që ka të punësuar rreth 140 anëtarë të stafit. Auditori i Përgjithshëm dhe ZAP janë të pavarur dhe që certifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare për çdo vit, derisa ndërmarrin forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjerë të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga ZAP në mënyrë direkte promovojnë llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për ti mbajtur llogaridhënës menaxherët e organizatave individuale buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur për opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Komunës së Suharekës në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm, Qerkin Morina, i cili ka bërë mbikëqyrjen e auditimit.

Opinionin dhe raportin i nxjerrë janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Florim Beqiri mbështetur nga Ramadan Gashi (Udhëheqës i ekipit), Enver Ramadani, dhe Qëndresa Sogojeva.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit.....	6
2 Pasqyrat vjetore financiare.....	8
3 Rekomandimet e vitit paraprak	9
4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli	11
5 Sistemi i auditimit të brendshëm	23
6 Konkluzioni i përgjithshëm	24
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZAP	25
Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak.....	27

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF-të) për vitin 2012 për Komunën e Suharekës. Me këtë rast, dëshiroj të falënderoj Kryetarin e Komunës dhe stafin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Auditimi i PVF për vitin 2012 ishte ndërmarrë në përputhje me Standardet e njohura Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (SNISA) të nxjerra nga INTOSAI. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat për të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare.

Auditimi është fokusuar në:

- Vlerësimin nëse PVF paraqesin pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale;
- Menaxhimin Financiar dhe Auditimin e Brendshëm, duke përfshirë menaxhimin dhe ekzekutimin e buxhetit; dhe
- Procedurat e pajtueshmërisë.

Opinion

Auditori i Përgjithshëm (AP) i raporton Kuvendit për opinionin e tij në formatin e përcaktuar në nën kapitullin 2.3 Opinioni i Auditimit. Shtojca I shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ana e ZAP. Raporti i AP-së përfshin një opinion për vërtetësinë dhe drejtësinë e PVF.

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Vjetore Financiare *prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale. **(SNISA: 400 Opinion i Pakualifikuar).**

Konkluzioni i përgjithshëm

Niveli i punës së ndërmarrë nga ana e ZAP për të përfunduar auditimin e vitit 2012 është pasqyrim i drejtpërdrejtë i cilësisë së mjedisit të kontrollit të brendshëm. Konkluzioni ynë i përgjithshëm është se:

Kryetari i Komunës kishte dizajnuar sistemin e kontrollit të brendshëm në nivel të knaqëshëm, por këto duhet në vazhdimësi të monitorohen për tu siguruar se janë duke

funksionuar siç duhet. Në vazhdim po i paraqesim fushat në të cilat janë vërejtur mangësitë e përshkruara në këtë raport.

Rekomandimet e auditimit kanë për qëllim të mbështesin Komunën e Suharekës në përmirësimin e kontrolleve financiare dhe rritjen e aspekteve tjera të aktivitetit operacional. Konkluzioni ynë i përgjithshëm është se nevojiten veprime të mëtejme për të adresuar disa rekomandime të rëndësishme nga viti i kaluar.

Kemi diskutuar cilësinë e raportimit financiar të Komunës së Suharekës dhe të gjeturat e tona të detajuara të auditimit në lidhje me Pasqyrat Vjetore Financiare, Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe Llogaridhënien e Menaxhmentit si dhe Auditimin e Brendshëm në pjesën kryesore të këtij raporti.

Rekomandimet tona kryesore për Kryetarin e Komunës janë si në vijim:

Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

- Duhet të ndërroj çasjen ndaj rekomandimeve të auditimit. Ato duhet të shqyrtohen në të gjitha nivelet e menaxhimit dhe të nxirret një Plan i qartë me të gjitha masat dhe veprimet e duhura për zbatim;
- Të analizoj në mënyrë gjithëpërfshirëse çështjen e të hyrave, si në kuptimin e planifikimit ashtu edhe në vendosjen e mekanizmave efektiv për realizimin e parametrave të planifikuar;
- Te vendos mekanizma të kontrollit për të siguruar se proceset e prokurimit janë në përputhje me ligjin e prokurimit publik, t'i identifikojë arsyet për vonesat në kryerjen e projekteve dhe duhet të ndërmerren veprime për t'u siguruar se ato kryhen brenda afateve kohore të pritura;
- Se dosjet e zyrtarëve të jenë azhurnuar mirë, vlerësimi i punëtorëve të kryhet në mënyrë periodike dhe njëjti të sistemohet në dosjen personale të zyrtarëve; dhe
- Të siguroj invenatrizimin e gjithave pasurive të komunës, në pajtueshmëri me kërkesat e UA me Nr. 21/2009 për menaxhimin e pasurive qeveritare.

Sistemi i Auditimit të Brendshëm

- Të gjeturat dhe rekomandimet e dhëna nga auditimi i brendshëm të diskutohen dhe adresohen menjëherë, aty ku është e mundur.

Përgjigje nga menaxhmenti - auditimi i vitit 2012

Menaxhmenti është pajtuar me të gjitha të gjeturat tona të auditimit dhe është zotuar se do ti adresojnë rekomandimet tona.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Është përgjegjësi e Komunës së Suahrekës të përgatis PVF sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme”. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshinë ekzaminimin dhe vlerësimin e PVF dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e opinioneve:

- Nëse PVF japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit ka reflektuar vlerësimin e rrezikut tonë të auditimit për Komunën e Suahrekës. Ne kemi konsideruar të kuptuarit tonë për organizatën, deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale dhe nivelin e testimit të hollësishëm të kërkuar gjatë përcaktimit të testimeve të përgjithshme e që janë të nevojshme për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmive për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm.

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

Një vlerësim i përgjigjeve të Menaxhmentit ndaj rekomandimeve të bëra në vitin 2011 mund të gjendet në Shtojcën II.

Ne kemi përfshirë gjetjet e rëndësishme dhe të tjera më pak të rëndësishme, që dalin nga auditimi ynë. Për plotësinë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të 9 mujorit aty ku ishte relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të rëndësishme - Çështjet kryesore për vëmendjen e atyre që janë të ngarkuar me qeverisje dhe menaxhmenti i lartë e që mund të ketë potencial të rezultojë në një dobësi materiale në kontrollet e brendshme; dhe

Të tjera - Dobësitë e identifikuara në auditimin tonë, ku veprimi do të ofrojë potencialin për përmirësime në efikasitet dhe efektivitet të kontrolleve të brendshme.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe janë shtrirë vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për

kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një deklaratë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive të cilat ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimet që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar.

2 Pasqyrat vjetore financiare

Rishikimi ynë i PVF merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informatave të regjistruara në PVF. Ne gjithashtu e konsiderojmë deklaratën e bërë nga ZKA dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur draft PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e PVF përfshin një numër të pohimeve për sa i përket pajtueshmërisë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të pasqyrave vjetore financiare. Një numër i pikave në deklaratë kanë për qëllim të ofrojnë siguri për Qeverinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

2.1 Pajtueshmëria me kornizën raportuese

Konkluzioni i përgjithshëm

PVF ishin përgaditur në pajtim me kërkesat e Rregullës Financiare nr. 07/2011, dhe SNKSP “Raportimi Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme” ku është përdorur formati standard i raportimit.

Përshkrimi

PVF duhet të jenë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me RrF Nr 07/2011;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048;
- PVF janë pranuar vetëm në gjuhën shqipe;
- PVF janë përgatitur në kopje fizike dhe elektronike; dhe
- Komuna ka përgatitur dhe ka dorëzuar raporte të rregullta tremujore tek Ministri i MF gjatë vitit 2012.

Ne kemi vërejtur se PVF-të nuk ishin përgatitur në gjuhën serbe.

Rekomandim

Ne rekomandojmë Kryetarin e Komunës që me rastin e përgatitjes së PVF duhet merret parasysh edhe obligimi ligjor që PVF të përgatiten edhe në gjuhën serbe.

2.2 Cilësia dhe saktësia e informatave të prezantuara në pasqyrat vjetore financiare

Konkluzioni i përgjithshëm

Komuna ka arritur të përgatisë PVF sipas Rregullës Financiare nr. 07/2011 mbi raportimin vjetor të organizatave buxhetore. Në PVF të përgatitura nga Komuna, nuk kemi vërejtur ndonjë parregullsi domethënëse.

Përshkrimi

Si rezultat i punës sonë audituese, janë bërë rregullime në draft PVF të paraqitura për auditim. Ne kemi dhënë një numër sugjerimesh tjera për të përmirësuar shpalosjet dhe për të siguruar plotësinë e informacioneve shpjeguese. Menaxhmenti ka marrë në konsiderim sugjerimet tona dhe ka bërë Shpalosjet e ndarjeve fillestare dhe finale të buxhetit, ashtu siç është kërkuar nga ne.

2.3 Opinioni i Auditimit

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Vjetore Financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale. (SNISA: 400 Opinioni i Pakualifikuar).

3 Rekomandimet e vitit paraprak

Konkluzioni i përgjithshëm

Menaxhmenti i komunës kishte hartuar planin e veprimit për të adresuar rekomandimet e dhëna në vitin e kaluar 2011, dhe ne vlerësojmë këtë përkushtim, por niveli i adresimit rekomandimeve edhe më tutje mbetet larg nivelit të kërkuar.

Përshkrimi

PVF për vitin 2011 ishin audituar nga kompania e auditimit "Grant Thornton" e cila ishte kontraktuar nga ZAP. Raporti i auditimit për PVF-të e vitit 2011 kishte rezultuar në 12 rekomandime kryesore. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi duke theksuar se të gjitha rekomandimet duhet të adresohen.

Ne kemi vërejtur se, dy (2) prej tyre ishin adresuar plotësisht; tetë (8) ishin adresuar pjesërisht, dhe dy (2) nuk ishin adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe se si janë adresuar ato, shih Shtojcën II.

Të gjeturat dhe Rekomandimet

1. Çështja - Adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak-Prioriteti i rëndësishëm.

E gjetura	Vetëm një pjesë e rekomandimeve të vitit të kaluar janë zbatuar.
Rreziku	Dobësitë e vazhdueshme të kontrolleve të brendshme në sistemet kyçe financiare kanë rezultuar joefikasitet të vazhdueshëm organizativ dhe vlerë e dobët për para në praktikën e prokurimit, vonesat në përmirësimin e kontrolleve që lidhen me të hyrat, zbatimin e politikave të personelit dhe prezantimin e pasurive.
Rekomandimi 1	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që plani i veprimit i rishikuar në mënyrë të qartë përcakton një afat kohor për adresimin e rekomandimeve me anëtarët e stafit llogaridhënës, të identifikuar - me fokus fillestar në ato të një rëndësie të madhe.

4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

4.1 Hyrje

Qasja jonë e auditimit është fokusuar në të kuptuarit dhe vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti për të siguruar menaxhim financiar dhe kontroll efektiv. Për sisteme individuale financiare, ne kërkojmë të identifikojmë nivelin në të cilin operojnë kontrollet aktuale. Kjo mund, për shembull, të jetë aktiviteti monitorues i ndërmarrë nga menaxhmenti i lartë apo kontrolleve operative të nivelit më të ulët. Ne konsiderojmë se kontrollet janë të dizajnuara mirë, janë zbatuar siç është planifikuar dhe funksionojnë në mënyrë efektive. Kjo kërkon një vlerësim të strukturave, proceseve dhe linjat e llogaridhënies të prezantuara nga menaxhmenti.

4.2 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Konkluzioni i përgjithshëm

Komuna ka realizuar 12,155,556€ nga buxheti i përgjithshëm prej 13,094,928€ apo 93%. Kjo është një performancë relativisht e mirë në krahasim me Komunitat tjera, edhe pse disa aspekte të menaxhimit të buxhetit duhet të rishikohen më tutje.

Përshkrimi

Ne kemi konsideruar burimin e fondeve buxhetore për komunën e Suharekës, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike dhe të hyrave të mbledhura. Kjo është theksuar në tabelat e më poshtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore – realizimi ndaj buxhetit (në Euro)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2012 Shpenzimi	2011 Shpenzimi	2010 Shpenzimi
Burimet e Fondeve:	12,206,484	13,647,027	12,155,556	11,655,181	9,205,355
Granti i Qeverisë-Buxheti	9,852,784	10,092,502	9,969,500	9,849,710	7,997,467
Të bartura nga viti paraprak	-	615,078 ²	547,088	1,154,675	282,928
Të hyrat vetjake	2,353,700	2,905,799 ³	1,609,666	608,781	904,027
Donacionet Vendore	-	5,465	5,000	10,534	16,950
Donacionet e Jashtme	-	28,183	24,302	31,481	3,983

Nga tabela 1 shihet se ka ndryshim në mes buxhetit fillestar dhe atij final për 1,440,543€. Ky ndryshim i buxhetit ka ardhur si rezultat i të hyrave vetjake të bartura nga viti 2011 në vlerë prej 615,078€, riplanifikim i të hyrave prej 552,099€ nga donacionet në vlerë 33,648€, dhe rritja e grantit qeveritar 239,718€.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- realizimi ndaj buxhetit (në Euro)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2012 Shpenzimi	2011 Shpenzimi	2010 Shpenzimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	12,206,484	13,647,027	12,155,556	11,655,181	9,205,355
Pagat dhe Mëditjet	5,929,898	6,100,229	6,041,205	5,811,928	4,595,909
Mallrat dhe Shërbimet	831,468	1,065,939	986,698	858,319	816,773
Komunalit	277,000	227,000	226,891	201,178	200,564
Subvencionet dhe Transferet	130,000	170,726	126,775	128,565	105,449
Investimet Kapitale	5,088,118	6,083,133	4,773,987	4,655,191	3,486,660

¹ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

² Të hyrat e bartura

³ Te hyrat vetjake të planifikuar.

Buxheti është shpenzuar rreth 93% në nivel të përgjithshëm, dhe mund të vlerësohet si një performancë shumë e mirë buxhetore. Një ngecje në realizimin e objektivave buxhetore vërehet tek Investimet Kapitale, ku janë ekzekutuar 85% nga ajo që ishte planifikuar për shkak të vonesave në projekte.

Tabela 3. Të hyrat vetjake të buxhetuara dhe realizuara (në Euro)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2012 Realizimi	2011 Realizimi	2010 Realizimi
Të hyrat vetjake	2,353,700	2,353,700	2,906,049	608,781	904,027

Komuna kishte arrit që të tejkaloj planin e inkasimit për 23%. Ky tejkallim i hyrave për vitin 2012 ka ardhur si rezultat i inkasimit të të hyrave të pa planifikuara nga shpronësimi i tokës për autostradë në vlerë prej 1,269,383€.

4.3 Kërkesat e raportimit

Konkluzioni i përgjithshëm

Komuna i ka përmbushur të gjitha kërkesat për raportim dhe ka respektuar afatet e kërkuara.

Përshkrim

Komuna e Suharekës i ka përmbushur obligimet për raportim të jashtëm si në vijim:

- Kërkesat Buxhetore;
- Raportet tremujore, duke përfshirë pasqyrat financiare nëntë mujore me kohë;
- Draft Plani dhe plani përfundimtar i prokurimit me kohë;
- Është përgatitur dhe dorëzuar në ZAP planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve të auditimit;dhe
- Raportet mbi borxhet e dorëzuara në MF.

4.4 Të hyrat (përfshirë të hyrat vetjake)

Konkluzion i përgjithshëm mbi të hyrat

Komuna e Suharekës, sa i përket të hyrave, ka vendosur kontrole në nivele të ndryshme prej inkasimit të të hyrave deri tek raportimi në PVF. Me gjithë përmirësimet, komuna duhet ta përgatitë një planifikim për tatimin në pronë të bazuar në analiza të mirëfillta sipas bazave të ngarkesave reale, si dhe të nxjerrë politika të qarta me mekanizmat e duhur se si të inkasohen borxhet e mbetura nga vitet paraprake. Në veçanti kontrole më efikase duhet të aplikohen tek të hyrat nga qiraja, ushtrimi i veprimtarisë afariste dhe tatimi në pronë.

Përshkrimi

Komuna e Suharekës gjatë vitit 2012, ka realizuar të hyra në shumë prej 2,906,049€, derisa të hyrat e planifikuara për vitin 2012 ishin 2,353,700€.

Të gjeturat dhe Rekomandimet

2. Çështja - Të hyrat e planifikuara - Prioriteti i rëndësishëm

- E gjetura** Komuna ka planifikuar që të realizoj të hyra gjatë vitit 2012 shumën prej 2,353,700€, ndërsa kishte realizuar shumën prej 2,906,049€ apo 123% nga shuma e planifikuar. Gjatë vitit 2012 janë inkasuar të hyra të pa planifikuara nga shpronësimi i tokës për autostradë në vlerë prej 1,269,383€, që rezulton se pa këtë shumë do të ishte një inkasim vetëm 70% nga planifikimi. Një shkallë më e ultë e inkasimit është regjistruar tek të hyrat nga qiraja, ushtrimi i veprimtarisë afariste, lejet e ndërtimit dhe tatimi në pronë.
- Rreziku** Politikat e planifikimit duket të jenë të dobëta për të siguruar maksimizimin e të hyrave, e po ashtu edhe kontrollet operative nuk janë mjaft efektive. Kësisoj mund të kemi një nënpagim të të hyrave. Vonesat në mbledhjen e të hyrave, sjellin edhe dështimet në vendimmarrjen e menaxhmentit për financimin e projekteve nga ky burim.
- Rekomandimi 2** Kryetari i Komunës duhet të ketë një çasje gjithëpërfshirëse në trajtimin e të hyrave, si në kuptimin e planifikimit ashtu edhe në vendosjen e mekanizmave efektiv për realizimin e parametrave të planifikuar. Menaxhmenti duhet të inicoj një proces rivlerësimi, ku të gjitha llogaritë do të analizohen në kuptimin e vjetërsisë, shumave domethënëse, mundësive reale për inkasim dhe ushtrimin e masave administrative (nëse ka nevojë).

3. Çështja - Vonesat e deponimeve të parave në bankë nga të hyrat e inkasuar - Prioriteti i rëndësishëm

- E gjetura** Kemi identifikuar se paratë e inkasuara në të gatshme nuk dorëzohen në bankë, dmth se mbahen më gjatë se që lejohet me ligjin për MFPP, respektivisht neni 58 siç parasheh, se të ardhurat vetanake komunale duhen të depozitohen menjëherë në llogarinë përkatëse zyrtare bankare.
- Rreziku** Risku i përdorimit të parave të gatshme është gjithmonë i lartë. Mosdorëzimi i parave të inkasuara në bankë brenda afateve të përcaktuara ligjore, rrit rrezikun e humbjes apo keqpërdorimit të parasë publike.
- Rekomandimi 3** Kryetari i Komunës duhet të siguroj se të gjithë inkasantët që mbledhin para të gatshme, në një afat sa më të shkurtër të njëjtat t'i depozitojnë në llogaritë bankare. Gjithashtu është i nevojshëm barazimi periodik (të paktën një herë në muaj) i parave të mbledhura në kesh dhe shumave të dorëzuara në bankë, dhe mos barazimet eventuale duhet sqaruar.

4.5 Shpenzimet

Konkluzion i përgjithshëm mbi shpenzimet

Komuna ndonëse ka të dizajnuara kontrole formale mbi shpenzimet, ato nuk operojnë në mënyrën e duhur. Pagesat për subvencione nga kategoria e investimeve kapitale, pagesat nga bashkëfinancimet dhe tejkalimi i paramasave dhe parallogaritjeve të punëve, janë vetëm disa raste që përshkruajnë dështimin e kontroleve.

4.5.1 Prokurimi

Përshkrimi

Blerjet e realizuara përmes procedurave të prokurimit për vitin 2012 ishin 5,034,294€.

Ne kemi ekzaminuar disa kontrata me vlerë totale 936,610€, që janë zhvilluar përmes procedurave të prokurimit, dhe i kemi testuar pagesat lidhur më këto kontrata.

Të gjeturat dhe Rekomandimet

4. Çështja - Pagesa e subvencioneve nga Investimet Kapitale - Prioritet i rëndësishëm

E gjetura Te lënda “Furnizim i bujqve me artikuj bujqësorë”, plehra artificiale, farë të patateve dhe pajisje për vreshtari dhe pemëtari, në vlerë prej 42,425€, kemi identifikuar se pagesa e faturës është bërë nga kategoria e investimeve kapitale, e jo nga subvencionet kur dihet se këto blerje nuk mund të jenë pasuri komunale.

Rreziku Dhënia e subvencioneve nga kategoria e investimeve kapitale është në kundërshtim me LMFPD dhe buxhetin.

Rekomandimi 4 Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që të gjitha shpenzimet e fondeve publike nga kategoria e investimeve kapitale të bëhen për projektet e parashikuara me buxhet, dhe jo për subvencione.

5. Çështja - Marrëveshje të bashkëfinancimeve pa specifikuar kushtet dhe kriteret- Proiritet tjetër.

E gjetura Te marrëveshja e bashkëfinancimit nr. 4913 të dt. 24/08/2011 në vlerë të përgjithshme prej 153,867€ në mes të Hidroregjionit Jugor-Prizren (51%) dhe komunës (49%), për „Inkuadrime të pusit 5 dhe 6 tek Pusi i Atit” në rrjetin e ujësjellësit në Suharekë, kemi vërejtur se në marrëveshje nuk ishte përcaktuar se si do të monitorohen procedurat e vlerësimit të tenderit dhe ekzekutimit të kontratës. Komuna kishte kryer pagesën pa ditur nëse punimet janë përfunduar sepse nuk kishte ndonjë raport të pranimit të punimeve.

Rreziku Nuk ishin zbatuar kontrole me rastin e pagesës së bashkëpjesëmarrjes. Mos ofrimi i dokumentacionit nga Hidro-regjioni tek komuna si (kontratën, specifikacionin e çmimeve, pjesëmarrësit në tender, raporti i pranimit të punëve), rrit rrezikun që certifikuesi i komunës të bëjë pagesën pa një kontroll të duhur.

Rekomandimi 5 Kryetari i Komunës duhet të sigurohet se në çfarëdo marrëveshje duhet t’i specifikoj qartë kriteret, objektivat, procedurat, detyrimet, shkallën e progresit dhe kontrollet e duhura. Dhe, pasi të jetë siguruar se të gjitha kushtet për pagesë janë plotësuar, të aprovoj pagesat.

6. Çështja - Vonesat në realizimin e punëve sipas planit dinamik- Prioritet tjetër

E gjetura Te kontrata nr. 2334 të dt. 07/05/2012 në vlerë prej 68,686€ për ndërtimin e rrugës lagja e Sopave Dragaqinë- Grejqevc, kemi vërejtur se punë-kryerësi nuk ka respektuar afatin kohor për përfundimin e punëve siç ishte paraparë më planin dinamik prej 20 ditë pune, pas nënshkrimit të kontratës, Pranimi teknik i punëve të kryera është bërë më 05/07/2012, me vonesë prej më tepër se një muaj.

Te Kontrata nr. 4699 të dt. 27/07/2012 në vlerë prej 286,040€ për ndërtimin e infrastrukturës në zonën industriale, kemi vërejtur se punëkryerësi nuk ka respektuar afatin kohor për përfundimin e punëve siç ishte paraparë më planin dinamik prej 30 ditë pune, pas nënshkrimit të kontratës,. Pranimi teknik i projektit ende nuk ishte kryer.

Te kontratat nr.7053 të dt. 31/10/2012 në vlerë prej 32,840€ „Ndërtimi i rrugëve lokale në fshatin Tërrne“, kemi vërejtur vonesa në realizimin e punimeve duke mos respektuar planin dinamik të punëve prej 50 ditë pune. Derisa ne ishim në auditim, punimet ende nuk ishin të përfunduara.

Rreziku Mosrespektimi i planit dinamik të punëve rrezikon që punët të mos kryhen dhe objektivat e menaxhmentit të mos të realizohen në kohën e planifikuar.

Rekomandimi 6 Kryetari i Komunës duhet të vendos procedurë të kontrolleve me rastin e pranimit të punëve, për t'u siguruar se kontratat po respektohen nga palët kontraktuese.

7. Çështja - Pagesat nga kodet jo përkatëse ekonomike-Prioritet tjetër

E gjetura Te marrëveshja e bashkëfinancimit nr.1341 të dt. 13/03/2012 për dhënie të bursave në vlerë të përgjithshme prej 51,000€ kemi vërejtur se këto pagesa janë bërë nga kodi ekonomik për investime kapitale.

Rreziku Pagesat e shpenzimeve nga kategoritë joadekuate ndikon në mbivlerësimin e një kategorie apo nënvlerësimin e shpenzimeve në kategorinë tjetër të shpenzimeve, me efekt çorientues të PVF-ve.

Rekomandimi 7 Kryetari i Komunës duhet të sigurojë se zyrtarët përgjegjës të financave bëjnë klasifikimin e duhur të shpenzimeve dhe i kryejnë regjistrimet e sakta sipas kategorive adekuate.

8. Çështja - Shpërblimi me kontratë operatorit të papërgjegjshëm - Pritoret i rëndësishëm

- E gjetura** Në kontratën me Nr.6901, të datës 29.10.2012, me vlerë prej 146,400 € për „Furnizim me lëndë djegëse dru ahu dhe thëngjill” kemi vërejtur se në dosjen e tenderit, nga AK janë kërkuar 3000m³, ndërsa me vërtetim të lëshuar nga Agjencia Pyjore e Kosovës, paraqitet se fituesi posedon vetëm 144m³ dru të licencuara.
- Rreziku** Vlerësimet e tilla rrisin rrezikun që OE të mos kenë kapacitete që të përmbushin obligimet kontraktore ndaj komunës, dhe kontrata të mos realizohet.
- Rekomandimi 8** Kryetari i Komunës duhet të sigurohet se Departamenti i prokurimit ka ndjekur të gjitha procedurat e duhura të vlerësimit, me rastin e përzgjedhjes së operatorëve, duke i vlerësuar edhe kapacitetet teknike dhe përmbushjen e kërkesave administrative.

9. Çështja - Sigurimi i ekzekutimit në vlerën shumëfish më të vogël sesa kërkohej me dosjen e tenderit-Prioritet i rëndësishëm.

- E gjetura** Te tenderi me nr. 624-12-039-521 „Ndërtimi i rrugës lokale në Gjinoc - faza e dytë, në vlerë prej 67,036€, gjatë testimit të procedurave të tenderimit kemi vërejtur se OE nuk e ka deponuar sigurimin e ekzekutimit të kontratës në vlerë prej 10% (6,703€), siç kërkohej në dosjen e tenderit, por ka paguar sigurimin e ekzekutimit kontratës vetëm 1,000€.
- Te kontrata me Nr.6901 e datës 29.10.2012, në vlerë prej 146,400€ për „Furnizim me lëndë djegëse dru-ahuh dhe thëngjill” gjatë testimit të procedurave të tenderimit kemi vërejtur se OE nuk e ka deponuar sigurimin e ekzekutimit të kontratës në vlerë prej 14,600€ , siç kërkohej në dosjen e tenderit, por ka paguar vetëm 1,460€.
- Rreziku** Komuna nuk ka respektuar kriteret e dosjes së tenderit duke pranuar sigurimin e ekzekutimit me të ultë se sa shkalla prej 10% nga vlera e kontratës, gjë që rrit rrezikun që operatori të mos përmbushë kontratën në afatet e përcaktuara.
- Rekomandimi 9** Kryetari i Komunës duhet të siguroj se menaxheri i prokurimit zhvillon procedurat e prokurimit që ndërlidhen me kërkesat e specifikuar të dosjes së tenderit, me synimin që të ngritet siguria e ekzekutimit të punimeve.

4.5.2 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Përshkrimi

Për kategorinë paga dhe mëditje buxheti final ishte 6,100,229€,ndërsa janë shpenzuar 6,041,205€, apo 99% e buxhetit të planifikuar.

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar (payrollit). Kontrollat që operojnë në nivel lokal nga komuna kanë të bëjnë me: a) kontrollimin i pagesave që janë nënshkruar në listën e pagave çdo muaj; b) verifikimet e ndryshimet të mundshme që mund të paraqiten përmes formularëve; c) rishikimin e buxheti për këtë kategori dhe të bëhen barazimet me thesarin.

Për këtë kategori testuam 60 mostra nga administrata komunale, drejtoria e shendetësisë dhe drejtoria e arsimit, ku rishikuam pajtueshmërinë e listaës së pagave me sistemin e payrollit në MAP.

Të gjeturat dhe Rekomandimet

10. Çështja - Dosjet jo mirë të azhurnuar - Prioriteti tjetër.

E gjetura Në dosjet e personelit nëpër shkolla kemi vërejtur disa mangësi të vogla, të cilat kërkojnë azhurnim të informatave shtesë. Nga ekzaminimet e mostrës kemi gjetur se në 15 dosje mungon vlerësimi vjetor dhe në 6 dosje mungon kalkulimi i pushimit vjetor.

Rreziku Zyrtarët përgjegjës nuk ka azhurnuar dosjet e personelit dhe për pasojë mund të ndodhin pagesa jo korrekte.

Rekomandimi 10 Kryetari i Komunës duhet të siguroj se dosjet e zyrtarëve të jenë azhurnuar mirë dhe vlerësimi i punëtorëve të kryhet në mënyrë periodike ashtu sic kërkohet me ligjet në fuqi.

4.5.3 Subvencionet dhe Transferet

Përshkrimi

Komuna për vitin 2012 kishte ndarë nga kjo kategori shumën prej 170,726€, nga të cilat janë shpenzuar 126,774 € apo 97% të buxhetit të planifikuar.

Subvencionet janë dhënë për përfituesit publik dhe jo publik në vitin 2012.

Komuna gjatë vitit 2012 nuk ka pasur rregullore të brendshme për ndarjen e subvencioneve dhe transfereve. Megjithatë, në këtë fushë është shënuar një progres. Në janar të vitit 2013, komuna kishte miratuar një Rregullore të tillë. Fakti se është miratuar kjo rregullore, është një sinjal i mirë se komuna ka kuptuar nevojën e posedimit të një akti rregullativ për të eliminuar mangësitë në këtë fushë

11. Çështja - Mungesa e dokumentacionit për përfituesit - Prioriteti i rëndësishëm

E gjetura Përfituesit e subvencioneve nuk kishin dorëzuar dokumentacionin e duhur, si: certifikatat për regjistrim biznesi, llogaritë bankare, letërnjoftimet, projektet e ofruara, si dhe nuk dorëzojnë raporte kthyese që dëshmojnë se mjetet e fituara nga kjo kategori janë shpenzuar në bazë të kërkesës dhe projekteve të ofruara.

Rreziku Mungesa e informatave kthyese, siç janë raportet financiare dhe raportet tjera përshkruese, nuk sigurojnë se shpenzimet e planifikuara për subvencione dhe transfere kanë arritur qëllimin.

Rekomandimi 11 Kryetarit i Komunës duhet të siguroj vendosjen e procedurave dhe kontrolleve të duhura për shpenzimet e subvencioneve, në pajtim me ndarjet fillestare buxhetore dhe kriteret sipas rregullores së miratuar.

4.6 Pasuritë

Konkluzioni i përgjithshëm mbi pasuritë

Komuna ka bërë një progres për regjistrimin e pasurive në krahasim me vitin paraprak, por ajo që mbetet ta bëjë menaxhmenti, është që komisioni për inventarizim të pasurisë të kryen dhe raporton me kohë për inventarizimin e gjithë pasurisë së komunës.

4.6.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Përshkrim

Menaxhimi i pasurisë është pjesë e rëndësishme e menaxhimit financiar dhe kontrollit në sektorin publik.

Komuna posedon regjistrin e pasurive me vlerë mbi 1,000€ të regjistruar në SIMFK, dhe programin për regjistrim të pasurive E-pasuria, ku janë regjistruar pasuritë me vlerën nën 1,000€.

Komuna ka një zyrtar të çertifikuar për mbajtjen, ruajtjen dhe regjistrimin e pasurisë. Ne kemi vërejtur se komuna ka regjistruar pasuritë në SIMFK, ku vlera neto në libra është 277,653,315€.

Të gjeturat dhe Rekomandimet

12. Çështja - Vonesat në inventarizimin e pasurive - Prioriteti i rëndësishëm

E gjetura Inventarizimi i pasurive është bërë për vitin 2012, por nuk është bërë në kohën e paraparë siç kërkohet me UA. Raporti për inventarizimin e pasurive është kryer me datë 03.04.2013.

Rreziku Mos kryerja me kohë e raportit të inventarizimit mund të rezultojë në mos përfshirjen e tyre në regjistrin e pasurive të prezantuara në PVF dhe në mos menaxhimin efektiv të pasurive.

Rekomandimi 12 Kryetari i Komunës duhet të sigurojë se raporti i inventarizimit të pasurisë të përfundohet me kohë, dhe që të gjitha informatat të shpalosen saktë në PVF.

13. Çështja - Regjistrimi i pasurive jo në bazë të dokumentave burimor - Prioritet tjetër

E gjetura Komuna ka regjistruar projekte që janë financuar nga ministrit e linjës, por këtë regjistrim e ka bazuar vetëm nga njoftimet për kontratë të Autoriteteve kontraktuese, dhe jo në bazë të dokumenteve burimore, si: CPO, kontrata, raporti i pranimit punëve, fatura etj, Edhe pse është vërejtur se zyrtarët komunal i janë drejtuar me shkresa ministrive përkatëse, nuk kanë arrit të sigurojnë dokumentat burimore për regjistrim.

Rreziku Bashkëpunimi i dobët në mes komunës dhe institucioneve tjera qeveritare, rezulton me mangësi informatash në regjistrimin e pasurive dhe nuk siguron menaxhim efektiv të pasurive.

Rekomandimi 13 Kryetari i Komunës duhet të siguroj regjistrimin e të gjithave pasurive të komunës, në pajtueshmëri me kërkesat e UA me Nr. 21/2009 për menaxhimin e pasurive qeveritare.

4.7 Trajtimi i borxheve

Konkluzioni i përgjithshëm mbi trajtimin e borxheve

Komuna kishte arrit t'i menaxhoj borxhet në mënyrë mjaft të mirë dhe në evidencat e saj gjinden disa borxhe të cilat janë evidentuar kryesisht gjatë ditëve të fundit të vitit.

Përshkrim

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnizuesve në fund të vitit 2012 ishte 45,148€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2013. Detyrimet kanë të bëjnë me mallrat dhe shërbimet 42,148€ dhe shpenzimet komunale 3,000€.

5 Sistemi i auditimit të brendshëm

Konkluzion i përgjithshëm mbi sistemin e auditimit të brendshëm

Njësia e auditimit të brendshëm përbëhet nga një auditorit që është njëherit edhe drejtor i NJAB. Puna e kryer nga auditimi i brendshëm konsiderohet e mirë dhe i kishte kontribuar sistemit të kontrolleve të brendshme në përmirësimin e disa dobësive.

Përshkrimi

NJAB ka hartuar planin strategjik dhe vjetor të auditimit për vitin 2012, dhe kishte planifikuar 6 auditime të rregullta dhe një ad hoc. Auditimet ishin kryer: (a) Drejtoria e Arsimit -të hyrat dhe shpenzimet, viti 2011 dhe Janar-Tetor 2012, (b) Drejtoria e Financave - të hyrat nga tatimi në pronë, tarifë ngarkesat e subjekteve afariste për vitin 2011; (c) Drejtoria e Prokurimit tre (3) raporte (një për vitin 2011 dhe dy për vitin 2012); dhe (d) Menaxhimi i pasurive për vitin 2012.

Gjithashtu, me vendim të Kryetarit NJAB kishte kryer auditimin ad hoc për QKMF në menaxhimi i shpenzimeve për automjete dhe gjenerator për perudhën 01.10.2011 deri me 29.02.2012.

Raportet janë mjaft cilësore dhe konsiderojmë se ishin kontribut i mirë për menaxhmentin për të kuptuar funksionimin e kontrolleve të brendshme.

Komuna ka themeluar komitetin e auditimit në vitin 2010. Gjatë kësaj periudhe të vitit 2012, komiteti i auditimit ka mbajtur pesë takime, ku janë shqyrtuar raporti vjetor i NJAB, shqyrtimi i raporteve të auditimit të kryera gjatë vitit 2012, dhe trajtimi i rekomandimeve të AB të dhëna për vitin 2012.

Ajo që vërehet si mangësi në fushën e auditimit të brendshëm është fakti se menaxhmenti nuk kishte përgatitur ndonjë Plan veprimi për diskutimin dhe adresimin e rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm. Zbatimi i rekomandimeve nuk ishte i kënaqshëm. Kjo çështje mendojmë se duhet të jetë në vëmendjen e menaxhmentit në të ardhmën.

6 Konkluzioni i përgjithshëm

Konkluzioni ynë është se Menaxhmenti i Komunës kishte dizajnuar dhe implementuar sistemin e kontrollit të brendshëm në nivel të kënaqshëm, por kontrollet ka nevojë të monitorohen në vazhdimësi për tu siguruar se janë duke funksionuar siç duhet. Në vazhdim po i paraqesim fushat në të cilat janë vërejtur mangësitë e përshkruara në këtë raport.

Rekomandimet janë adresuar vetëm pjesërisht, dhe ne mendojmë se menaxhmenti duhet të adresoj zbatimin e tyre në të gjitha nivelet e menaxhimit, me kërkesën që ato të përmbushen maksimalisht, me theks të veçantë ato me rëndësi prioritare. Plan veprimi duhet bëhet edhe për rekomandimet e auditimit të brendshëm.

Buxheti ka nevojë të përmirësohet në fazën e ekzekutimit. Dobësi të ekzekutimit shihen te buxheti për shpenzimet kapitale prej 85%.

Menaxhmenti kishte një performancë të mirë në inkasimin e të hyrave, ku kishte arritur të realizoj 123% të planit, por një shumë e konsiderueshme e këtyre të hyrave ka të bëjë me të hyrat e shpronësimit. Është vërejtur një rënie e të hyrave në krahasim me vitin 2011, tek te hyrat nga qiraja, ushtrimi i veprimtarisë afariste, lejet e ndërtimit dhe tatimi në pronë. Gjithashtu, edhe vonesat e deponimeve të parave në bankë nga hyrat e inkasuar.

Në fushën e prokurimit, vërehen poashtu disa mangësi. Si vonesa në realizimin e projekteve (planeve dinamike), dhe siguria e ekzekutimit të kontratave shumëfish më e vogël se sa është kërkuar në dosjen e tenderit.

Departamentit i personelit duhet të kompletoj dhe azhurnoj dosjet, për t'iu shmangur pagesave të parregullta.

Menaxhmenti ka treguar një përkushtim të madh për rezultatet e auditimit dhe ne presim se mangësitë dhe dobësitë e identifikuara në raport do të adresohen brenda një afati optimal.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga SNISA 400)

9. Një opinion i auditimit normalisht është një format standard, ndërlidhur me pasqyrat financiare si tërësi, duke shmangur nevojën për të caktuar gjatësinë e saj por duke bartur sipas natyrës së saj një kuptim të përgjithshëm tek lexuesit sipas kuptimit të saj. Natyra e këtyre fjalëve do të ndikohet nga korniza ligjore të auditimit, por përbërja e opinionit duhet të tregoj qartë a është i pakualifikuar apo i kualifikuar, apo nëse është i kualifikuar në disa çështje të caktuara apo është opinion i kundërt (paragrafi 14), apo është mohim i opinionit (paragrafi 15).

10. **Një opinion i pakualifikuar** jepet kur auditori është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale që:

- a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke shfrytëzuar baza dhe politika të pranuar të kontabilitetit të cilat janë zbatuar në mënyrë konsistente (të qëndrueshme);
- b) pasqyrat janë në pajtim me kërkesat statusore dhe rregulloret relevante;
- c) pamja e paraqitur në pasqyrat financiare janë në përputhje me njohuritë e auditorit në lidhje me entitetin e audituar;
- d) është një shpalosje adekuate e të gjitha çështjeve materiale relevante për pasqyrat financiare.

11. **Theksi i çështjeve.** Në disa rrethana auditori mundet të konsideroj se lexuesi nuk do të kuptoj në mënyrë të duhur pasqyrat financiare nëse vëmendja është përqendruar në çështje të pazakonshme apo të rëndësishme. Si një rregull e përgjithshme, auditori kur jep një opinion të pakualifikuar kjo nuk i referohet ndonjë aspekti specifik të pasqyrave financiare në opinionin e tij në rast se kjo mund të interpretohet gabimisht si opinion i kualifikuar. Me qëllim të shmangies së kësaj përshtypjeje, referencat që janë menduar si; nënvizim i çështjes; gjinden në paragrafët e ndara nga opinionin. Sidoqoftë, auditori nuk duhet të përdor nënvizimin e çështjes për të përmirësuar mungesën e shpalosjeve të duhura në pasqyrat financiare apo si alternativ, zëvendësim për kualifikim të opinionit.

12. Auditori mund të mos jetë në gjendje të shpreh një opinion jo të kualifikuar kur ekziston një nga ato rrethana dhe në gjykimin e auditorëve, afektin e tyre është ose mund të jetë materiale për pasqyrat financiare:

- a) Ka pasur limitime në fushëveprimin e auditimit;
- b) Auditori konsideron që pasqyrat janë jo komplete apo çorientues apo ekziston një ndarje e pajustificuar nga standardet e pranueshme të kontabilitetit; apo
- c) Ekzistojnë paqartësi që ndikojnë në pasqyrat financiare.

13. **Opinionit i Kualifikuar.** Aty ku auditori nuk pajtohet apo nuk është i sigurt në lidhje me një ose me tepër artikuj të veçantë në pasqyrat financiare e që janë materiale por jo edhe fundamentale në kuptimin e pasqyrave, duhet të jepet një opinion i kualifikuar. Formulimi i opinionit normalisht tregon një rezultat të kënaqshëm ndaj subjektit të audituar, sa i përket një pasqyre të qartë dhe koncize, të çështjeve të mospajtimit apo edhe të paqartësive që ngrisin opinion e kualifikuar. I ndihmon përdoruesit e pasqyrave nëse efekti financiar i paqartësisë apo edhe i mosmarrëveshjeve është përcaktuar nga ana e Auditorit edhe pse kjo nuk është gjithmonë praktike apo relevante.

14. **Opinionit i Kundërt.** Aty ku Auditori nuk ka mundësi të jap një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, për shkak të mosmarrëveshjeve që është aq thelbësore ngase e minon pozitën e prezantuar në vazhdim që opinionit që kualifikohet në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, atëherë jepet opinionit i Kundërt. Formulimi i një opinionit të tillë e bën të qartë se pasqyrat financiare nuk janë prezantuar në mënyrë të drejtë, duke specifikuar qartë dhe në mënyrë koncize të gjitha çështjet e mosmarrëveshjeve. Përsëri, është një ndihmesë që efekti financiar mbi pasqyrat financiare përcaktohet aty ku duhet dhe është praktik.

15. **Mohimi i Opinionit.** Aty ku Auditori nuk mund të jep opinion në lidhje me pasqyrat financiare, të marrë si tërësi për shkak të paqartësisë apo restriksionit të fushëveprimit që është thelbësor që një opinion që është i kualifikuar në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, jepet opinionit i kundërt. Formulimi i një opinionit të tillë e bënë të qartë që një opinion nuk mund të jepet, duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha çështjet e paqarta.

16. Është bërë zakon që ISA të ofrojnë një raport të detajuar për të plotësuar opinionin në rrethana në të cilat është e pamundur të jepet një opinion jo i kualifikuar.

Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandimet plotësisht te adresuara	Rekomandimet pjesërisht të adresuara	Rekomandimet e pa adresuara
5. Pasqyrat Financiare.	<ul style="list-style-type: none"> Përgatitja e pasqyrave financiare të Komunës duhet të përfshijë procedurat dhe mjetet që janë paraqitur për të siguruar që informacioni i kërkuar është i regjistruar, përpunuar, përmbledhur dhe raportuar në mënyrë të përshtatshme në pasqyrat financiare. Paraqitja e pasqyrat financiare në gjuhën serbe siç kërkohet nga ligjet aktuale. 	X		X
6.1 Të hyrat	<ul style="list-style-type: none"> Të bëhet implementimi i një sistemi të faturimit, i cili mund të ndërlidhet me softuerët e kontabilitetit. Të bëhet lidhja e njësive operative 		X X	

	<p>dhe të faturimit automatikisht dhe të kryej barazime(bashkërendime) të rregullta në mes tyre, në rastet kur faturimi është i lidhur drejtpërdrejtë me shërbimet e ofruara nga njësitë operative. Kjo është veçanërisht e rëndësishme atëherë kur ekzekutohet një vëllim i madh i transaksioneve.</p> <ul style="list-style-type: none">• Të sigurohet se paratë e gatshme të mbledhura të deponohen në bankë brenda afatit të kërkuar.		
--	---	--	--

6.2.2 Spenzimet- Prokurimi	<ul style="list-style-type: none"> • Vendosja e proceduarave kontrolluese adekuate, për monitorim efektiv për të siguruar përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi. • Të aplikojë ashtu siç duhet termet dhe kushtet kontraktuale dhe të aplikojë dënimet kur kontraktuesi përfundon projektin në kohë. 		X	
6.2.3 Subvencionet	<ul style="list-style-type: none"> • Të vendosën procedura kontrolluese adekuate të mjaftueshme për monitorim efikas në pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret në fuqi. 		X	
6.3.1 Paraja gatshme	<ul style="list-style-type: none"> • Të sigurohet se paratë e gatshme të mbledhura nga pjesëmarrja të deponohen në bankë brenda afatit të kërkuar. 			X
6.3.2 Llogartie e	<ul style="list-style-type: none"> • Llogaritë e arkëtueshme të jenë të 		X	

arketushme	shpalosur në mënyrë të mjaftueshme dhe të hollësishme për të siguruar të dhëna të sakta të debitorëve (borxhlive) dhe janë regjistruar në mënyrë që të mundësojnë Komunën të pregadisë një buxhet të besueshëm dhe të saktë, të raportoje shkallën e saktë të mbledhjes, dhe të ndjekë mbledhjen e të hyrave vetanake.			
6.3.3 Asetet kapitale dhe jo-kapitale	<ul style="list-style-type: none"> Të zhvilloj dhe komunikojë një grup të politikave dhe procedurave që kanë të bëjnë me pronën, impiantet dhe pajisjet në përputhje me udhëzimin dhe termet e Udhëzimit Administrativ nr. 21/2009 		X	
6.4 Borgjet	Të respektohen të gjitha dispozitat e Udhëzuesit të Thesarit dhe rregullës financiare 02- "Shpenzimet e parave publike" të lëshuar nga Qeveria e Kosovës dhe të shlyej detyrimet brenda 30 ditëve.		X	
7.1 Kontrolli i brendshem.	<ul style="list-style-type: none"> Të focohe kontrollet e përgjithshme financiare, administrative dhe menaxheriale; 		X	

	dhe te marrë veprimet e menjëhershme për sigurimin e një trajtimin më të mirë në të metat në zbatimin e kontrollit të brendshëm.			
8. Konkluzioni i përgjithshëm.	<ul style="list-style-type: none"> Të përpilohen politika të qarta për të gjitha aktivitetet e rëndësishme të Komunës dhe të hartojë një plan veprimi duke specifikuar veprimet e menjëhershme. 	X		

